



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2022:170188

Datë: 18.09.2024

Numri i dokumentit: 06174188

P.nr.292/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurës R.D., nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1663/2022 të datës 19.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, i datës 12.09.2024, në praninë e prokurores së shtetit Vyrtyte Gërvalla, të dëmtuarës V.A., përfaqësuesi me autorizim av.R.B., të pandehurës R.D. dhe mbrojtësit të saj sipas autorizimit av.V.H., pas shpalljes së aktgjykimit më datë 12.09.2024, më datë 18.09.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

E PANDEHURA: R.D. nga i ati A..., e ëma D..., e vajzërisë A..., data e lindjes..., ne komunën e Vushtrrisë, me vendbanim në komunën e Vushtrrisë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, e ve, e pa punë, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, më parë e pa gjykuar.

ËSHTË FAJTORE

SEPSE: Më datë 10.08.2022, rreth orës 18:40, në banesën e saj të përbashkët, në Vushtrri, e pandehura me dashje nuk i bindet urdhrit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë Dega në Vushtrri-Divizioni Civil me numër C.nr.310/22, ashtu që e pandehura nuk e respekton urdhrin mbrojtës të Gjykatës së lartcekur me të cilin i është ndaluar që ta shqetëson kumatën e saj tani të dëmtuarën Vahide, në atë mënyrë që derisa e dëmtuara kishte hyre në banjo, e pandehura i kishte trokitur në derë të banjës disa here duke e shqetësuar të njëjtën e me i’ a kishte hap derën e duke i thënë “boll ma, mos perzij dollavere”,

- Me këtë ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, 70 dhe nenit 393 të KPRK-së, si dhe nenit 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, e

G J Y K O N

TË PANDEHURES: R.D. i shqipton DËNIM MË GJOBË në shumën prej njëmijë (1000) euro, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Në rast se e akuzuara refuzon të paguajë këtë dënim me gjobë, atëherë ky dënim me gjobë do të shndërrohet në dënim me burg, duke i caktuar të akuzuarit për çdo 20 euro (njëzet euro) të dënimit me gjobë, nga 1 (një) ditë burgim.

Pala e dëmtuar V.A. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej tridhjetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 1663/2022 të datës 19.08.2022, kundër të pandehurës R.D., nga komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 20.07.2023, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit Albana Parduzi, e dëmtuara V.A., përfaqësuesi me autorizim av.R.M. dhe e pandehura R.D.. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës iu jepet mundësia e deklarimit rreth fajësisë, e njëjta ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë. Gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar të pandehurën se në afat prej 30 ditësh ata mund të paraqesin, kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë, si dhe kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor me datë 27.05.2024, në të cilën seancë kanë prezantuar prokurorja e shtetit Vyrtyte Gërvalla, e dëmtuara V.A., përfaqësuesi me autorizim av.R.B., e pandehura R.D. dhe mbrojtësi me autorizim av. V.H.. Pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit në kuptim të nenit 320 të KPPK-se, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se e pandehura e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtës iu jepet mundësia e deklarimit rreth fajësisë, e njëjta ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe meqenëse e pandehura nuk e ka pranuar fajësinë gjyqtari ka mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor në të cilën seancë janë administruar provat personale.

Deklarimi i të pandehurit për pranimin e fajësisë

Në seancën e vazhdimet të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 12.09.2024 e pandehura R.D. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e kësaj veprë dhe i premtun gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëritet më vepra të ngjashme penale, gjithashtu i kërkon falje të dëmtuarës dhe deklarohet se ky pranim i fajësisë është bërë pas konsultimeve me avokatin mbrojtës.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se meqenëse të pandehurës i garantohet e drejta që në çdo faze të procedurës të bëjë pranimin e fajësisë, por prapë duke pasur parasysh kohën kur është bërë ky pranim i fajësisë pasi të ketë përfunduar në tërësi kjo procedurë gjyqësore dhe ka mbetur vetëm shpallja e aktgjykimit, gjykatës i propozon që të aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga ana e të pandehurës, pasi që si i tillë ky deklarim i saj gjenë mbështetje edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, por kjo rrethanë të mos të i merret si rrethanë lehtësuese sepse nuk i ka kontribuar në asnjë mënyrë efikasitetit të kësaj procedure dhe si e tillë nëse kjo rrethanë i merret si rrethanë lehtësuese, gjykatës i kërkon që kjo rrethanë që të mos merret si rrethanë posaçërisht lehtësuese. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se duke pasur parasysh që e pandehura është deklaruar fajtor për këtë veprë penale, i ka propozuar gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të i ketë parasysh rrethanat rënduese si faktin se kjo veprë penale ka rezultuar të jetë kryer brenda marrëdhënies familjare, rregullim ky i paraparë me Ligji për Dhunën në Familje si dhe me përkufizimet e KPPK-se, të merret si rrethanë rënduese edhe shkalla e lartë e dashjes në veprimet e të pandehurës dhe faktin se të dy palët në vazhdimësi kanë pasur probleme mes vete ashtu që e pandehura ka qenë në njohuri të plotë për pasojat e mosrespektimit të urdhrin mbrojtës, ku vetë veprimet me të cilat e ka kryer këtë veprë , pa asnjë mëdyshje absorbojnë dashje direktet në veprimet e saj. Ndërkaq si rrethanë lehtësuese në këtë çështje penale nuk ka dhe ka shtuar se i propozon gjykatës që sipas detyrës zyrtare e sipas mundësive të pajiset me një certifikatë nga e evidencat penale ashtu që varësisht nga ajo rezulton të i merret si rrethanë lehtësuese respektivisht rënduese.

E dëmtuara lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës. Ndërsa në fjalën përfundimtarë ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e avokatit mbrojtës dhe po ashtu do të kërkon kompensimin e dëmit material dhe jo material lidhur me këtë çështje. dhe shton që të merren parasysh gjendja psikike në kohën kur ka ndodhur rasti, gjatë kohës sa kemi qenë duke bashkëjetuar dhe kohës pasi që jemi ndarë.

Përfaqësuesi me autorizim i palës së dëmtuar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka deklaruar se e pajtohet me pranimin fajësisë nga ana e të pandehurës. Ndërsa në fjalën përfundimtarë ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e prokurorit të shtetit ndërsa sa i parkete kërkesës për kompensimin e dëmit material dhe jo material e lë në vetë diskrecionin e palës së dëmtuar që të deklarohet.

Mbrojtësi me autorizim i të pandehurës lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës ka

deklaruar se pas konsultimeve me të mbrojturën e tij në këtë seancë i njëjta në mënyrë vullnetare dhe pa imponime e pranon në tërësi veprën penale për të cilën ngarkohet nga prokuroria e shtetit, dhe i propozon gjykatës që të bëjë pranimin e fajësisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se gjatë përcaktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit të merren rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë dhe fakti se e njëjta është zotuar se nuk do të ndodh ndonjë problem në të ardhmen.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në vazhdimin e shqyrtimit gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me dispozitat e nenit 322 lidhur me nenin 242 par.2 të KPPK-së. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i pandehuri, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: raporti fillestar i incidentit me numër të rastit 2022-BD-737, i datës 10.08.2022, raporti i policit, i datës 10.08.2022, raporti ditor i Dhunës Familjare, i datës 10.08.2022, raporti i shpejtë, i datës 04.06.2020, procesverbali mbi marrjen në pyetje të dyshuarit R.D., i datës 10.08.2022, procesverbali mbi marrjen në pyetje të viktimës- dëshmitares V.A., i datës 10.08.2022 dhe urdhëresa për mbrojtje me numër të lëndës C.nr.310/22 nga Gjykata Themelore në Mitrovicë Dega në Vushtrri, i datës 20.07.2022.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se e pandehura ka kryer veprën penale Mospërfillja e gjykatës nga neni 393 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 185, par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Mospërfillja e gjykatës e kryen “*Kushdo që nuk i bindet ndonjë urdhri, vendimi apo aktgjykimi të plotfuqishëm të ndonjë gjykate në Republikën e Kosovës ose refuzon apo pengon publikimin e vendimit apo aktgjykimit të plotfuqishëm të gjykatës së tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj.*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurën ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqyrtimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69, 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, pendimin e të pandehurës për kryerjen e kësaj vepre penale, premtimin që i ka bërë gjykatës se nuk do të

përsërisë më vepra penale të kësaj apo natyrës tjetër, kërkesë faljen ndaj palës së dëmtuar në seancë si dhe faktin se e pandehura nuk ka qenë i dënuar me aktgjykim të formës së prerë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata ka gjetur shkallën e përgjegjesisë penale, zvarritjen e procedurës penale pasi që e njëjta nuk i'u është përgjigjur thirrjeve të gjykatës në raport me seancat e caktuara, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur si dhe faktin se kjo veprë penale është kryer brenda familjes dhe vetë ligji e parasheh si rrethanë rënduese.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana, gjykata vlerëson se shqiptimi i dënimit me gjobë në shumën prej njëmijë (1000) euro, ndaj të pandehurës është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjesisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, kompensimin e viktimave të krimit dhe shpenzimet e procedurës

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që tërë kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil apo të paraqes kërkesë në Programin për Kompensim të Viktimave nëse i plotëson kushtet e atij programi.”*, ashtu që në rastin konkret në shqyrtimin gjyqësor me datë 12.09.2024 pala e dëmtuar ka kërkuar për realizimin e kërkesës pasurore – juridike.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 36 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.292/22, datë 18.09.2024

GJYQTARI

Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.